

V E N D I M
Nr.495, datë 18.7.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË PERSONAVE DHE SASISË SË
NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT**

(Ndryshuar me VKM nr, 57, datë 29.1.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të nenit 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen në portet e peshkimit të Shëngjinit, të Durrësit, të Vlorës dhe të Sarandës, brenda zonës doganore, të stacioneve të shitjes së gazoilit (diezel) për anijet e peshkimit të licencuara për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

2. Tregtimi i karburanteve për furnizimin e anijeve të peshkimit të bëhet vetëm nga persona juridikë, të pajisur me lejet përkatëse, në përputhje me ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

3 *Shoqëria furnizuese e gazoilit për anijet e peshkimit të jetë “ARMO” sh.a., Fier. Çmimi i shitjes të jetë sipas përcaktimit të çmimit me shumicë, të publikuar nga kjo shoqëri.¹*

4. Gazoili t’u shitet Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP), sipas porteve të peshkimit, të cilat duhet:

a) të paraqesin kërkesën dhe grafikun e nevojave të anijeve të peshkimit për furnizimin me naftë;

b) të organizojnë grumbullimin dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar në udhëzimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Takim-Taksave, dalë në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, i ndryshuar.

5. Rimbursimi i akcizës t’i bëhet drejtpërdrejt shoqërisë furnizuese një herë në tre muaj, në bazë të dokumenteve të paraqitura nga OMP-të e peshkimit.

6. Në bazë të numrit të anijeve të peshkimit dhe të fuqisë motorike të tyre, sasia e gazoilit për 1 vit nuk duhet t’i kalojë sasi të mëposhtme:

- a) Durrës 10 000 tonë;
- b) Vlorë 9 000 tonë;
- c) Shëngjin 6 000 tonë;
- ç) Sarandë 3 000 tonë.

7. Për periudhën 1 korrik 2003 deri në 31 dhjetor 2003 sasia e gazoilit për nevojat e peshkimit të jetë, për portet e përmendura në pikën 6 të këtij vendimi, sa gjysma e sasisë vjetore.

8. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet kapitenerive të porteve, Ministria e Rendit Publik, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë (Drejtorisë së Policisë Kufitare), si dhe Ministria e Financave, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe asaj të Takim-Taksave, të ndjekin procedurat e nisjes dhe të mbërritjes së anijeve të peshkimit për dhe nga zonat e peshkimit.

9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Takim-Taksave të nxjerrin udhëzimet për regjistrin e karburanteve të anijeve të peshkimit dhe regjistrin e furnizimit

VKM nr. 57, datë 29.1.2004, botuar në F.Z nr. 4 datë 2.6.2004, ne piken 2 te tij shprehet: “Rimbursimi i akcizës të fillojë më datë 1 janar 2004”

të stacioneve të shitjes së karburanteve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano